



Dalës-Idazn:

Nr. IX-03
Br.

Data 11.01.2023
Datum

OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIÇIT
OPŠTINA OBILIC - MUNICIPALITY OF OBILIC



DREJTORIA PËR MBROJTJE TË MJEDISIT

Datë/Data/Date:	11/01/2023
Për/Za/To:	z.XhaferGashi - Kryetar
Nga/Od/From:	Fitore Hashani - Drejtore
Tema/Subjekat/Subject	Raporti i punës së DMM-së për vitin 2022



Duke u bazuar në nenin 62 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nën 86 të Statutit të Komunës, Ligjin për Mjedisin, Rregulloret e Planet e Punës, Ligjin për Financat Publike, Ligjin e Prokurimit Publik, UA dhe Buxhetin për vitin 2022, DMM ka realizuar këto punime;

Në fushën e projekteve;

- Parku dhe fusha në fshatin **Llazarevë** (nr.083/2021), vlera e kontratës: 39,717.49 €
- Parku në qytet (**këndi i lodrave në sheshin “Dëshmorët e kombit”**), vlera e kontratës: 62,811.01 €
- Parku dhe fusha në **“Mbretëreshën Teutë”** (nr.073/2021), vlera e kontratës: 105,995.93 €
- **Furnizimi me kontejner**, vlera e kontratës: 10,000.00€
- **Mbjellja e drunjve** (nr.074/2021), vlera e kontratës: 162,890.00€
- **Kogjenerimi – Objekti** (nr.047/2020), vlera e kontratës: 917,917.91€, me kohëzgjatje dy (2) vite pra është përfunduar kontrata në dhjetor 2022, me pagesen e situacionit të fundit në vlerë 77,747.00€
- **Kogjenerimi - mbikqyrja** (nr.046/2022), vlera e kontratës: 355,490.54€ me kohëzgjatje tre(3) vite, ndërsa në vitin 2022 është paguar situacioni i parë sipas planit të punës dhe kontratës, në vlerë 30,000.00€
- **Kogjenerimi - shtrirja e rrjetit**(nr.1/2022), vlera e kontratës 11,849,684.51€, me kohëzgjatje tre (3) vite, ndërsa në vitin 2022 është paguar situacioni i parë bazuar në kushtet e kontratës, në vlerë 1,480,873.68€

Në fushën e legjislacionit;

- Aprovimi i Rregullorës Nr.07/2022 për Menaxhimin e Mbeturinave, Draft Plani për Mbeturinat dhe Draft Plani për Ajërin.

Në fushën e inspektimit(gjobat, mbledhja e të hyrave);

-Duke respektuar UA për Gjobat Mandatore kemi shqiptuara shtatë (7) gjoba duke arritur të mbledhim të hyra në vlerë 650.00€.

Në fushën e shqyrtimit të kerkesave dhe lëndëve;

- Gjatë vitit 2022 janë shqyrtuar treqind e pesëdhjetë e pesë (355) kërkesa të palëve (natyra e kërkesës; leje mjedisore, pëlqime, ankesa, njoftime)
-leje mjedisore (mbledhja e të hyrave), - gjatë vitit 2022 kemi lëshuar nëntë (9) leje mjedisore duke mbledhur të hyra në vlerë 8,242.90€

Në fushën e mirëmbajtjes së hapësirave gjelbëruese;

-Monitorimi dhe bashkëpunimi mes dy kompanive në fushën e mbeturinave, KRM "PASTRIMI" dhe NPL "KASTRIOTI" Sh.A, me të cilat si aksionar kemi lidhur edhe kontratat për kryerjen e shërbimeve në fushën e mbeturinave dhe mirëmbajtjes.

Në fushën e bashkepunimit;

-Me MMPHI, IHMK, KMDK, KMMK; Rreth legjislacionit, agjendave të gjelbra, planeve dhe ndikimeve në mjedis, trajtimit të deponive dhe mirëmbajtjes së tyre.

Në fushën e deponive ilegale;

-Pastrimi i deponive me bashkëpunimin e KEK, KMDK, KRM "PASTRIMI", NPL "KASTRIOTI" Sh.A, OJQ "TA PASTROJME KOSOVEN", "DEMOKRACIA PLUS" etj!

DMM vitin 2022, bazuar në planin e punës e konsideron të suksesshëm duke përmbushur kështu objektivat e parapara si dhe duke e realizuar buxhetin e planifikuar për këtë vit.

Me respekt!

Obiliq, janar 2023